

---

**VENDIM**

**Nr. 2 Datë 20.01.2010**

**PËR**

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “CEZ TRADE ALBANIA” SH.P.K  
NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9, dhe nenit 45 pikat “3” dhe “4”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “f”, nenve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20 .01.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k për liçensim në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

**Dhe Konstatoi se :**

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k ka nisur me marrjen e vendimit Nr.85, Datë 04.11.2009.
- Dokumentacioni për aplikimin për liçensimin për kryerjen e aktivitetit të Furnizuesit të Kualifikuar të energjisë elektrike është paraqitur i plotë konform përcaktimeve të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të liçensojë shoqërinë “CEZ Trade Albania” sh.p.k në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike me afat të vlefshmërisë së liçensës 5 vjet.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s  
Bujar Nepravishta**